



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

DOKUMENTI I RREGULLORES SË VEÇANTË

LEJE ZHVILLIMI PËR OBJEKTIN: "PARK FOTOVOLTAIK " AEROPORTI I KUKËSIT" ME
KAPACITET PRODHUES 12 MW", ME VENDODHJE NË BASHKINË KUKËS, ME SUBJEKT ZHVILLUES
SHOQËRINË "GLOBAL TECHNICAL MECHANICS" SH.P.K.

MIRATOHET
KRYETARI I K.K.T.U



Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Znj. BELINDA BALLUKU



Miratur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit Nr. 55 Datë 26.03.2025

Projektues:

VEGA SOLAR
BROS. Architects



Zhvillues:

Global Technical Mechanics



TABELA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES SË VEÇANTË

1. Dispozita të Përgjithshme
 - 1.1 Baza Ligjore
 - 1.2 Përshkrim i zonës së studiuar
 - 1.3 Pozicioni
2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor
 - 2.1 Seti i fragmenteve të hartave të PPV për zonën në zhvillim
3. Projekti i Propozuar
 - 3.1 Treguesit e Zhvillimit
4. Infrastruktura Ekzistuese
 - 4.1 Si lidhet zhvillimi i propozuar me infrastrukturën ekzistuese?



1 Dispozita të Përgjithshme

1.1 Baza Ligjore

Kjo rregullore e veçantë përcakton kushtet e përgjithshme të Lejes së Ndërtimit për objektin:

LEJE ZHVILLIMI PËR OBJEKTIN: "PARK FOTOVOLTAIK "AEROPORTI I KUKËSIT" ME KAPACITET PRODHUES 12MW," ME VENDODHJE NË BASHKINË KUKËS, ME SUBJEKT ZHVILLUES SHOQËRINË "GLOBAL TECHNICAL MECHANICS" SH.P.K.

bazuar në:

✚ Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", indryshuar nenit 7 dhe neni 28.

✚ Vendimin Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

✚ Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Kukës, miratuar me Vendim Nr. 1. datë 25.04.2023 të Këshillit Kombëtar të Territorit. "Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Kukës, të miratuar me Vendimin nr. 8, datë 08.02.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit.

✚ Vendimi Nr. 822, datë 7.10.2015 Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike.


1.2 Përshkrim i zonës së studiuar

Zona në të cilën mendohet të shtrihet projekti ka një sipërfaqe prej 935,873m². Ajo ndodhet në një distancë prej 3.5 km në jug të qytetit të Kukësit, pranë fshatit Shtiqen dhe në tenitorin e Aeroportit të Kukësit

Koordinatat gjeografike: 42°02'11.0"N 20°25'04.9"E

Terreni i përzgjedhur për ndërtimin e impiantit fotovoltaik ndodhet në një zonë fushore, brenda perimetrit të Aeroportit të Kukësit, i cili nuk është shfrytëzuar më parë për qëllime bujqësore. Mospërdorimi i këtij territori për kultivim është diktuar nga funksioni dhe rëndësia e tij për ruajtjen e sigurisë së aeroportit.

Karakteristikat gjeografike dhe fizike të këtij terreni janë të përshtatshme për ndërtimin e impianteve fotovoltaike të instaluar në tokë. Projekti është konceptuar në mënyrë të tillë që të respektojë distancat e përcaktuara nga pista e aeroportit dhe të mos ndërhyjë në operimin apo sigurinë e infrastrukturës ekzistuese. Zhvillimi i këtij projekt-propozimi nuk ndikon negativisht në funksionimin e Aeroportit të Kukësit dhe përputhet me kriteret e sigurisë dhe rregulloret përkatëse.



1.3 Pozicioni

Projekti “Park fotovoltaiik “Aeroporti i Kukësit” do të shtrihet në një sipërfaqe rreth 10.7 ha.

Impianti fotovoltaiik do të zhvillohet në parcelat me numër pasurie sipas Vendimit Nr.95, datë 20.02.2004 .





Figura 1. Pamje satelitore e vendndodhjes së impiantit fotovoltaiik








Figura 2. Fotografi të zonës



2.1 Seti i fragmenteve të hartave të PPV për zonën në zhvillim

LEJE ZHVILLIMI PËR OBJEKTIN: “PARK FOTOVOLTAIK “AEROPORTI I KUKËSIT” ME KAPACITET PRODHUES 12MW,” ME VENDODHJE NË BASHKINË KUKËS, ME SUBJEKT ZHVILLUES SHOQËRINË “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” SH.P.K.




Figura 3. Harta e propozuar e kategorive të përdorimit të tokës






Figura 4. Harta e ndarjes së territorit në 5 sisteme në nivel Bashkie





Figura 5. Harta e fazave të zbatimit të PPV.






Figura 6. Kategoria e përdorimit të tokës



3. Projekti i propozuar

Projekti mund të sjellë ndikime pozitive në zonë për shkak të rritjes direkte dhe indirekte të punësimit në zonë dhe më gjerë, si dhe rritjes së shpenzimeve të punëtorëve. Do të ndikojë në hapjen e vendeve të punës gjatë fazës së ndërtimit si dhe gjatë asaj të operimit të projektit.

- Gjatë kohës së ndërtimit do të hapen rreth 20-30 vende të reja pune për një periudhë 4 mujore.
- Gjatë kohës së operimit do të jenë të punësuar rreth 2-3 specialist dhe puntorë.
- Me ndërtimin e centralit fotovoltaiik “Aeroporti i Kukësit” energjia elektrike e prodhuar në vend do të rritet në masën rreth 16,111,510 kWh/vit.

Ndërtimi dhe operimi i centralit fotovoltaiik “Aeroporti i Kukësit 12 MW” është në përputhje të plotë me strategjinë kombëtare për rritjen e kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

- Rritja e vazhdimësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji, duke siguruar rritjen e mirëqenies;
- Zhvillimi i burimeve të brendshme energjitike të energjisë primare në një mënyrë të qëndrueshme dhe konkurruese;
- Përmirësimi kost-efektivitetit i sistemeve të furnizimit me energji elektrike;
- Prodhon energji elektrike pa ndotje të mjedisit, redukton emetimin e karbonit në masën rreth 9512 ton/vit CO₂ ;



✚ Kontribuon në rritjen e prodhimit vendas duke rritur pavaresinë nga importi i energjisë.


✚ Panelet FV dhe strukturat ndihmëse përbëhen nga materiale të riciklueshme, përfshirë qelqin, materialin gjysmëpërçues, çelikun, drurin, aluminin, bakrin dhe plastikën. Kur Projekti FV të arrijë fundin e jetës së tij operacionale, pjesët përbërëse do të çmontohen dhe riciklohen. Projekti do të çmontohet dhe çaktivizohet duke përdorur pajisje konvencionale me ndikim minimal në mjedis. Këto materiale do të riciklohen ose hidhen në mënyrë të sigurt në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi në kohën e çmontimit.

Nr.	Kërkesa	Të dhënat
1	Emri Aplikuesit	Shoqëria "Global Technical Mechanics" sh.p.k
2	Adresa Biznesit	Kukës Shtiqen SHTIQEN Në Kukës, Shtiqen, Njësia Administrative Shtiqen, (Aeroporti i Kukësit).
3	Qarku (projektit)	Kukës
4	Bashkia (projektit)	Kukës
5	Njësia Administrative (projektit)	Shtiqen
6	Vendodhja (projektit)	Aeroporti i Kukësit
7	Sipërfaqe e projektuar e tokës	107,403 m ²
8	Sipërfaqe modulesh	56,980 m ²
9	Fuqia në dalje AC	12 MW
10	Prodhimi Mesatar Vjetor	16,111,510 kWh/vit
11	Tipi i burimit gjenerues të energjisë	Luxor Eco Line Half Cell Bifacial
12	Lloji i qelizës	Monokristalinë, Bifacial
13	Numri i njësive gjeneruese	18,232 copë
14	Kapaciteti i njësisë gjeneruese	660 Wp
15	Afati i pritshëm i vënies në punë	2025



16	Jetëgjatësia e pritshme e burimit	25 vite
17	Numri i orëve të punës në vit	1340 orë/vit
18	Rendimenti i burimit gjenerues(sipas TC – Kushteve standarte të testimit)	deri në 21.01%
19	Standarti fizik i modulit (përmasat)	2,384 x 1,303 x35 mm Pesha = 34 kg
20	Niveli i tensionit në dalje të gjeneratorit (inverterave)	3P/PE ,800Vac
21	Vlera e parashikuar e investimit total	5,054,276.6 Euro
22	Rrezatimi mesatar diellor - GHI (Global Horizontal Irradiation) - DNI (Direct Normal Irradiation)	1,553.6 kWh/m ² 1,342.3 kWh/m ²
23	Prodhimi Specifik Vjetor	1,339 kWh/kWp/vit
24	Këndi Optimal i panelit	25° / 10°
25	Orientimi i Parkut	Jug (13°)
26	Tipi i Inverterit	SUNGROW SG350 kVA
27	Numri i Inverterave	32 copë
28	Përlllogaritja e emetimit të gazeve të efektit serë nga burimet gjeneruese dhe nëse ato janë në përputhje me normat.	9,512 ton/vit CO ₂ të evituara/shmangura

Tabela 1. Të dhënat e përgjithshme sipas kërkesave nga VKM Nr. 822, datë 07.10.2015¹, e ndryshuar²



3.1 Treguesit e Zhvillimit:

TREGUESIT E ZHVILLIMIT :

Sipërfaqe e përgjithshme e truallit:	107,403 m ² /
Sipërfaqe e truallit e zënë nga panelet fotovoltaike	56,980 m ² /
Lartësia maksimale e struktures nga kuota e sistemit :	2.3m

TREGUESIT E PRODHIMIT :

Kapaciteti i Prodimit (MW):	12 MW
Prodimi vjetor i energjisë elektrike (MWh):	16,111,510 kWh/vit
Numri i paneleve të instaluar :	18,232 panele

TREGUESIT E PRONAVE TË PARKUT FOTOVOLTAIK T:

Sipas Vendimit Nr.95, datë 20.02.2004 Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme,që preken nga ndërtimi i aeroportit të Kukësit dhe i rrugëve të reja të tij.

ZK 2762, ZK 3425, ZK2584




Figura 7. Planvendosja e strukturës që propozohet



4 Infrastruktura Ekzistuese

4.1 Si lidhet zhvillimi i propozuar me infrastrukturën ekzistuese?

Projekti për ndërtimin e impiantit fotovoltaiik “Aeroporti i Kukësit 12 MW” i cili do të zhvillohet në zonën e aeroportit të Kukësit (brenda perimetrit të aeroportit) në njësinë Administrative Shtiqen, Bashkia Kukës. Pika e lidhjes së impiantit me sistemin energjetik do të realizohet në nënstationin 110/35/10 kV Rexhepaj , pranë qytetit të Kukësit.

Lidhja e impiantit me rrjetin elektroenergjetik do të realizohet nëpërmjet nënstationit ekzistues 110/35/10 kV Rexhepaj, pranë qytetit të Kukësit. Impianti do të lidhet me këtë nënstation përmes një linje ekzistuese kablllore 20 kV, me gjatësi rreth 6.1 km, e ndërtuar më parë si linjë rezervë për të lidhur Aeroportin e Kukësit me Nënstationin Rexhepaj me përcjellës NA2AS(F)2Y 3x1x240/25 mm² Alumin.

Në Nënstationin Rexhepaj do të ndërtohet një stacion ngritës 20/35 kV, i cili do të shërbejë për ngritjen e tensionit të transmetimit nga impianti fotovoltaiik në nivelin 35 kV, në përputhje me tensionin e rrjetit ekzistues të shpërndarjes. Ky stacion ngritës do të mundësojë lidhjen e Impiantit Fotovoltaiik “Aeroporti i Kukësit 12 MW” si dhe të HEC-it privat “Cerneleva” me zbarat e përbashkëta 35 kV të Nënstationit ekzistues 110/35/10 kV Rexhepaj – Kukës, duke garantuar integrim të sigurt dhe të koordinuar në rrjetin elektroenergjetik.

Pozicioni gjeografik i linjës kablllore ekzistuese shtrihet në Jug-lindje të qytetit të Kukësit, duke filluar nga Parku fotovoltaiik “Aeroporti i Kukësit 12 MW” dhe vijon në drejtimin veri-lindor për të arritur në nënstationin Rexhepaj pranë qytetit të Kukësit.



Figura 8. Paraqitje grafike e lidhjes së parkut me infrastrukturën ekzistuese në Nënstationin 110/35/10 kV Rexhepaj-Kukës.

